

9 gusht 2021



Banka e Shqipërisë  
Departamenti i Politikës Monetare




Komisioni Evropian<sup>1</sup>

### Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

**Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)** u rrit përsëri në muajin korrik, me 4.1 pikë krahasuar me muajin qershor. Niveli aktual i tij, 110.4 pikë, përbën vlerën më të lartë të katër viteve të fundit (Grafik 1). Rritja e TNE-së u përcaktua nga përmirësimi i besimit në të gjithë sektorët e biznesit. Ndërkohë, besimi konsumator mbeti i pandryshuar nga niveli i muajit qershor (Grafik 2).

**Grafik 1.** Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

**Treguesi i besimit të industrisë (TBI)** u rrit me 4.3 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar, i ndikuar kryesisht nga vlerësimet pozitive të bizneseve për *prodhimin aktual*. Vlerësimi i tyre për kontratat *porositëse në total* ishte pak më i ulët se ai i muajit qershor, ndërsa ishin më optimistë për rritjen e kontratave *porositëse nga eksportet*. Gjithashtu, bizneset e industrisë presin rritje të *prodhimit* dhe të *punësimit* në muajt në vijim (Tabelë 2, sektori i industrisë).

<sup>1</sup> Vrojtmet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian. Prej muajit qershor 2021, publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtmet publikohen me frekuencë mujore.

**Treguesi i besimit në ndërtim (TBN)** vijoi prirjen rritëse në muajin korrik, duke qëndruar në nivelin më të lartë të pesë viteve të fundit. TBN-ja u rrit me 5.8 pikë përqindje në krahasim me një muaj më parë, e ndikuar nga të dy komponentët përbërës: *porositë aktuale* dhe *aktiviteti ndërtues aktual* (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

**Grafik 2.** Treguesit e besimit sipas sektorëve\*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: \*Grafiku paraqet seri të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

**Treguesi i besimit në shërbime (TBSH)** regjistroi rritje për të katërtin muaj rresht, duke arritur nivelin më të lartë që nga muaji maj 2018. Rritja e tij me 8.6 pikë përqindje në muajin korrik u ndikua si nga komponenti i lidhur me *ecurinë e biznesit* ashtu edhe nga komponenti i lidhur me *kërkesën* (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

**Treguesi i besimit në tregti (TBT)** vijoi prirjen rritëse të nisur që nga muaji gusht i vitit të kaluar. Aktualisht TBT-ja shënon nivelin më të lartë të pesë viteve të fundit. Në krahasim me muajin e kaluar, TBT-ja u rrit me 4.8 pikë përqindje, e ndikuar kryesisht nga vlerësimet e bizneseve për *ecurinë aktuale të biznesit* të tyre. Komponenti tjetër i TBT-së, pritjet për *punësimin* në të ardhmen, regjistroi një rritje të ulët gjatë muajit korrik (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


**Treguesi i besimit konsumator (TBK)** mbeti i pandryshuar në muajin korrik, në krahasim me një muaj më parë, pasi kishte shënuar rritje në tre muajt paraardhës. Niveli i tij qëndron ende nën mesataren e vet afatgjatë. Komponentët përbërës të TBK-së shënuan ndryshime me kahe të kundërta. Nga njëra anë, vlerësimi i konsumatorëve për *blerjeve aktuale në shuma të mëdha dhe pritjet* për to u përmirësuan në korrik; nga ana tjetër, pritjet për *situatën e përgjithshme ekonomike* dhe situatën e tyre *financiare* ranë lehtë (Tabelë 2, konsumatorët).

**Grafik 3.** Situata e biznesit sipas sektorëve gjatë 3 muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 4.** Pritjet për situatën e biznesit gjatë 3 muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 4.** Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 5.** Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Tabelë 1.** Treguesit e besimit sipas sektorëve\*

	Vlerat			2021						Situata aktuale	
	min	mes	maks	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Koniunkturale**	Strukture***
Industri	-60.3	-12.6	7.7	-22.1	-15.1	-8.4	-9.7	-11.7	-7.5	↑	+
Ndërtim	-57.1	-30.3	-10.4	-29.4	-26.4	-15.4	-16.2	-16.2	-10.4	↑	++
Shërbime	-47.0	3.8	23.2	-6.5	-7.1	2.7	9.2	14.1	22.7	↑	++
Tregti	-31.9	-4.3	19.2	-0.6	-0.6	4.0	11.1	14.4	19.2	↑	++
Konsumator	-40.7	-24.5	-16.2	-31.7	-32.0	-29.2	-26.7	-26.3	-26.4	=	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

\*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga maji 2016.

\*\*) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

**Tabelë 2.** Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2020		2021						
	Nënt	Dhjet	Jan	Shkur	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr
<b>INDUSTRIA</b>									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	-24.0	-14.4	-16.5	-7.4	5.9	7.9	16.9	15.0	24.2
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-30.0	-28.8	-24.6	-24.0	-19.6	-16.6	-19.6	-18.4	-19.3
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-37.5	-35.4	-31.7	-35.0	-31.8	-16.4	-26.3	-31.8	-27.3
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-10.1	-10.3	-9.9	-8.6	-6.5	-5.6	1.3	-2.9	-4.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	20.6	21.4	24.1	27.6	25.8	29.0	27.6	31.6	37.4
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	2.1	4.5	2.8	5.3	6.3	9.6	7.9	11.2	16.7
Punësimi pritje (pyetja 7)	1.4	-0.3	-2.5	1.0	4.5	3.9	7.1	10.1	16.4
<b>NDËRTIMI</b>									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	-17.9	-24.8	-11.7	-15.2	-7.0	3.9	10.8	9.1	17.7
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-46.9	-48.6	-49.5	-43.6	-45.8	-34.7	-43.2	-41.5	-38.6
Punësimi pritje (pyetja 4)	2.5	4.6	4.6	1.2	7.4	9.8	8.0	15.2	16.3
Çmimet pritje (pyetja 5)	5.5	5.0	5.9	7.1	10.2	9.3	6.9	10.0	8.3
<b>SHËRBIME</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	-11.6	-12.5	-14.5	-7.3	-4.4	3.9	10.9	15.7	23.3
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	-16.2	-14.2	-19.0	-5.7	-9.8	1.5	7.4	12.4	22.0
Kërkesa pritje (pyetja 3)	12.7	11.6	19.6	28.3	26.5	35.4	40.6	35.1	39.9
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	-7.2	-19.0	-14.9	-13.2	-8.3	-5.4	-5.2	1.4	18.6
Punësimi pritje (pyetja 5)	4.8	9.2	5.7	9.4	4.2	14.1	12.7	14.2	18.8
Çmimet pritje (pyetja 6)	-0.6	3.2	-6.3	3.3	4.4	3.2	-0.2	8.9	10.7
<b>TREGTIA</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	-17.0	-10.8	-9.2	-0.3	0.4	8.4	18.9	23.2	32.3

Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	-4.1	-5.2	-5.2	-6.4	-4.1	-6.0	-1.1	2.0	-1.5
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	16.4	15.5	21.5	21.6	16.9	21.4	29.3	29.5	32.0
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	20.6	18.9	24.0	27.1	24.9	28.1	37.7	32.3	35.2
Pritje për ecurinë e biznesit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	-2.9	0.7	-0.1	-0.9	-1.5	-0.4	3.3	5.6	6.1
<b>KONSUMATORI</b>									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-15.6	-15.6	-15.8	-15.0	-17.5	-15.7	-10.1	-12.0	-11.0
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	-4.9	-2.3	-0.1	0.8	0.2	1.5	3.4	4.2	3.8
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-31.0	-27.5	-29.4	-24.2	-26.4	-25.4	-20.0	-20.3	-20.6
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	-9.7	-8.2	-5.4	-4.8	-5.2	-0.4	2.1	4.4	2.5
Çmimet aktuale (pyetja 5)	-0.2	-3.6	-6.2	-6.4	-4.5	-5.0	-5.0	-2.7	1.5
Çmimet pritje (pyetja 6)	-11.9	-14.1	-16.8	-13.6	-15.4	-15.7	-17.3	-19.0	-11.8
Papunësia pritje (pyetja 7)	22.9	18.1	19.7	17.0	15.5	10.3	8.1	6.5	8.1
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-69.5	-70.8	-74.0	-67.4	-66.8	-65.9	-62.9	-64.7	-63.2
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-58.7	-58.6	-56.8	-55.5	-56.4	-51.9	-49.3	-49.3	-48.5
Kursimi aktual (pyetja 10)	-55.0	-54.3	-52.4	-50.0	-51.2	-49.5	-47.2	-46.0	-45.6
Kursimi pritje (pyetja 11)	-55.5	-53.1	-52.4	-49.8	-49.7	-48.4	-45.3	-44.4	-44.9
Gjendja aktuale financiare (pyetja 12)	-0.4	0.4	-0.7	1.1	-0.9	0.8	2.6	2.5	2.2

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## **Aneks**

### **Shpjegime metodologjike**

**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vrojtimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE)** ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.